

SHËNDETËSIA NË FRANCË

Të drejtat e mia

Sapo mbërrita në Francë, dëshiroj të marr trajtim. Nuk kam plotësuar asnjë dosje për sigurimet shoqërore. Mund të shkoj të vizitoj një mjek:

- Në spitalet që kane krijuar qendra të kujdesit shëndetësor(PASS). Më pas merrem nën kujdes nga mjekë, dhe medikamentet mund të më dorëzohen pa pagesë.
- Në disa shoqata të caktuara (përkujdesje dentare, oftalmologjike, psikologjike...)
- Pranë shërbimeve të mbrojtjes së nënave dhe fëmijëve (PMI) të cilët janë përgjegjës për monitorimin e fëmijëve nga 0 deri në 6 vjeç dhe vaksinimin e tyre.

**KU TË MERRNI INFORMACION ?
TEK ADRESA IME E CPAM IM OSE NË FAQEN E INTERNETIT :
AMELI.FR**

Përmbledhje

Nuk kam mbulim mjekësor:

Mund të shkoj tek një doktor në qytet por do të më duhet të paguaj vetë shpenzimet për shërbimin.

Përndryshe, unë mund të shkoj në një PASS ose në një shoqatë e shëndetësisë

Kam mbulim mjekësor:

Marr takim me një mjek.
E pyes nëse tarifat e tij mbulohen nga sigurimi im mjekësor (CMU, AME ose tjetër).

PUMa/

Bën të mundur që një pjesë e kujdesit shëndetësor dhe barnave me recetë nga mjeku të mbulohen.

AME dhe CMUc

Nuk bëj asnjë pagesë paraprake Kujdesi shëndetësor mbulohet direkt nga sigurimi shoqëror.

